



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO**

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Zyra Rajonale Gjilan, Rruga Bujanovci, 60000 Gjilan (Fabrika e Baterive IBG)

E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org), web: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## **NJOFTIM PËR LIKUIDIM**

**të**

**NSH Banja e Kllkotit – Fi 682/89, Kllkot, Rajoni i Gjilanit**

**Emrat alternativë/emrat e mëparshëm dhe numrat e regjistrimit:**

**DP Kllkot Banja –Fi 682/89**

Në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-067 Mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 39.3 dhe 39.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/6 mbi Organizatat Tregtare, dhe Neni 43.3 (d) dhe (e) dhe Neni 49 i Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Pasurisë së tyre, **JEPET NJOFTIMI se Likuidimi i Ndërmarrjes së lartpërmendur ka filluar prej 08 nëntor 2010**, në bazë të vendimit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit më **23/24 shtator 2010** sipas Nenit 9.1 të Ligjit Nr. 03/L-067.

Në përputhje me nenin 43.3 (d) dhe (e) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, çdo person i cili beson se ai/ajo ka të drejtë kërkesë ndaj kësaj Ndërmarrjeje – qoftë si kreditor apo në lidhje me çfarëdo lloj aseti që ka të bëjë me Ndërmarrjen, apo si pronar i Ndërmarrjes, si dhe çfarëdo kërkesë tjetër – **duhet të paraqesë Dëshminë e Kërkesës për Likuidim deri më ose para 18 janarit 2011**. Nëse nuk bëhet kjo, mund të rezultojë që personat e tillë nuk do të kenë mundësi të marrin pjesë në ndarjen e fondeve të krijuara nga likuidimi.

Dëshmia e Kërkesës për Likuidim mund të merret dhe duhet të dorëzohet në zyrën e AKP-së si më poshtë:

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Zyra Rajonale Gjilan, Rruga Bujanovci, 60000 Gjilan (Fabrika e Baterive IBG)

Telefoni: +381 0280 328 444

Fax: +381 0280 326 000

Formularët për kërkesa gjithashtu mund të merren edhe nga faqja e internetit e AKP-së në adresën [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org). Për detaje se si të dorëzohet kërkesa, shih “Si të paraqitni një kërkesë.”

Lista e aseteve dhe lista e paraqitësve të kërkesave do të mbahet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në **Zyra Rajonale Gjilan, Rruga Bujanovci, 60000 Gjilan (Fabrika e Baterive IBG)** dhe do të jetë e hapur për shqyrtim publik në këtë zyrë pas **18 janarit 2011** (ose ndonjë datë tjetër që mund të shpallet publikisht) deri në njoftimin e ardhshëm. Nëse keni arsye të pranueshme për pamundësinë e udhëtimit deri në vendin e lartpërmendur, ju lutemi të kontaktoni në adresën e mësipërme për të aranzhuar mënyra tjera të qasjes.

Asetet do të ofrohet për shitje nëpërmes tenderit me oferta të mbyllura në datën (jo me herët se **01 janar 2011**) që do të publikohet, duke përfshirë edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ([www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)).